



RAPORT MONITORIMI MBI PROCESIN E DECENTRALIZIMIT TË SHËRBIMEVE SOCIALE



KOMUNA IME, E DREJTA IME SOCIALE

RAPORT MONITORIMI MBI PROCESIN E DECENTRALIZIMIT
TË SHËRBIMEVE SOCIALE

Përmbytja

Përmbledhje ekzekutive	09
Qëllimi	12
Metodologjia	12
Korniza ligjore	13
Të gjeturat kryesore nga monitorimi i procesit të decentralizimit të shërbimeve sociale	15
Mungesa e vullnetit politik për zbatimin e decentralizimit të shërbimeve sociale	16
Mos zbatimi i decentralizimit të buxhetit për shërbime sociale	17
Paqartësitë sa i përket kompetencave të institucioneve për shërbime sociale	26
Mungesa e kapaciteteve për menaxhimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale në komuna	29
Përfundim	33
Rekomandime	35
Shtojca	39

Ky publikim u mundësua në kuadër të projektit “Aksioni i Përbashkët për Decentralizim”, projekt i financuar nga Bashkimi European dhe i menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë, i cili implementohet nga Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF në partneritet me Organizatën për Fëmijët pa Kujdes Prindëror – OFAP, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë dhe KMOP.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e konsorciumit të udhëhequr nga KOMF dhe nuk pasqyron me doemos pikëpamjet e Bashkimit European.

Autorë:

Bukurezë Surdulli, Specialiste për Monitorim dhe Hulumtim në KOMF

Donjetë Kelmendi, Drejtor Ekzekutiv në KOMF

Falenderime

Në emër të misionit të përbashkët për mbrojtjen, respektimin dhe avancimin e të drejtave të fëmijëve në Kosovë, Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF falenderon të gjithë ata që kontribuan në hartimin e këtij raporti, i cili ka qëllimin të nxisë dhe ndihmojë në përmbylljen e procesit të decentralizimit të shërbimeve sociale.

KOMF shpreh një falenderim të veçantë për të gjithë ata që u angazhuan dhe u përfshinë në këtë monitorim:

- Qendrat për Punë Sociale në Prishtinë, Prizren, Pejë, Ferizaj, Fushë Kosovë, Lipjan dhe Kamenicë
- Drejtoritë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Prishtinë, Prizren, Pejë, Ferizaj, Fushë Kosovë, Lipjan dhe Kamenicë
- Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamentin e Politikave Sociale dhe Familjes
- Organizatat anëtare të KOMF

Shkurtesat

DMS	Drejtoria Komunale e Mirëqenies Sociale
DPSF	Departamenti për Politika Sociale dhe Familjare
DSHMS	Drejtoria Komunale e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijës
KOMF	Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve
LFPL	Ligji për Financat e Pushtetit Lokal
LSHSF	Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare
LVL	Ligji për Vetëqeverisje Lokale
MeF	Ministria e Financave
MM	Memorandum Mirëkuptimi
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
QPS	Qendra për Punë Sociale
SOS	SOS Fshtrat e Fëmijëve Kosovë
UA	Udhëzim Administrativ



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Përmbledhje ekzekutive

Raporti i monitorimit të decentralizimit të shërbimeve sociale vërteton se procesi i decentralizimit të shërbimeve sociale nuk është përmbyllur edhe pas 10 vitesh. Arsyeja kryesore e mos zbatimit të këtij procesi është mungesa e vullnetit politik si nga ana e nivelit qendror, ashtu edhe nga ana e nivelit komunal. Nga gjithsej shtatë komuna në të cilat është bërë monitorimi i decentralizimit të shërbimeve sociale, ka rezultuar se në asnjë prej tyre, procesi i decentralizimit të shërbimeve sociale nuk është zbatuar. Qeveria deri më tani, nuk e ka pasur asnjëherë prioritet zgjidhjen e problemit të financimit për shërbime sociale apo decentralizimin e buxhetit për shërbime sociale, gjë që konsiderohet thelbësore për përmbylljen e këtij procesi. Ndërkaq, komunat vazhdojnë të neglizhojnë marrjen e përgjegjësisë për menaxhimin e shërbimeve sociale.

Bazuar në të gjeturat e monitorimit, shërbimet sociale janë në gjendje shumë të rëndë dhe po përballen me sfida të shumta, përfshirë: mungesën e financimit të qëndrueshëm të shërbimeve sociale, cilësinë e ulët të shërbimeve, kapacitetet e kufizuara, mungesën e infrastrukturës, llogaridhënien e ulët, paqartësitë në ndarjen e përgjegjësisë në mes të nivelit qendror dhe komunal, paqartësitë në ndarjen e funksioneve të monitorimit dhe inspektimit, mungesën e të dhënave të përfituesve si dhe mungesën e bashkëpunimit dhe komunikimit në nivel horizontal dhe vertikal.

Aktualisht, ende nuk është bërë kostimi i shërbimeve sociale, nuk është hartuar formula e financimit për shërbime sociale dhe nuk është krijuar plani për financim të qëndrueshëm të shërbimeve sociale nga MPMS dhe Komunitet, prandaj është e domosdoshme që të ndërhyhet nga të dy nivelet: qendror dhe komunal (MPMS dhe komunitet) deri në sigurimin e një zgjidhjeje të qëndrueshme të financimit të shërbimeve sociale, konkretisht krijimin dhe aplikimin e Grantit Specifik për Shërbime Sociale. Komunitet nuk kanë krijuar një skemë të qëndrueshme të kontraktimit për blerjen e shërbimeve sociale nga sektori jo-qeveritar apo ai privat, aktualisht mbështetja ndaj OJQ-ve ofrohet në baza ad hoc dhe përmes subvencionimit. Kjo mënyrë e financimit po ndikon në shuarjen e shërbimeve të ofruara nga sektori jo-qeveritar, prandaj rekomandohet ndërhyrje e menjëhershme nga dy nivelet deri në aplikimin e Grantit Specifik.

Mos zbatimi i decentralizimit të shërbimeve sociale njerëzore ka krijuar një sistem të shërbimeve sociale në Kosovë, i cili trajton dhe menaxhon vetëm rastet e rënda emergjente të cilëve ju rrezikohet jeta, siguria apo mirëqenia apo “rastet pasi kanë rënë viktimë e ndonjë forme të abuzimit”. Si pasojë, vetëm një pjesë e vogël e qytetarëve në nevojë kanë mundësinë të marrin shërbime sociale. Përveç kësaj ka mungesë të ofrimit të shërbimeve të parandalimit dhe re-integrimit për personat në nevojë për shërbime sociale. Për më tepër, për disa prej fëmijëve apo personave në nevojë për shërbime sociale, sistemi nuk ofron asnjë shërbim, si fjala bie për fëmijët apo personat viktimë të abuzimit me substanca narkotike, fëmijët e përfshirë në punë të rënda etj.

Raporti konstaton që komunitet kanë mungesë të kapaciteteve për planifikimin, menaxhimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale në komunitet. Drejtoritë Komunitet për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, vazhdojnë të çalojnë në krijimin e një stafi profesional dhe efektiv brenda këtyre drejtorive. Në veçanti, raporti tregon poashtu që kapacitetet e komunitet dhe Qendrave për Punë Sociale për planifikim dhe menaxhim të buxhetit për shërbime sociale janë të dobëta, prandaj rekomandohet që kapacitetet brenda QPS-ve të ngrihen, për planifikim dhe menaxhim të buxhetit.

Institucionet e të dyja niveleve vazhdojnë të kenë paqartësi në përgjegjësitë e tyre lidhur me shërbimet sociale. Konkretisht paqartësitë lidhen me raportimin dhe komunikimin. Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare duhet të parashikojë qartë ndarjen e përgjegjësisë lidhur me shërbimet sociale. Krahas kësaj, rekomandohet standardizimi i formave të raportimit dhe ndarjes së të dhënave në nivel horizontal dhe vertikal, duke pasur parasysh ruajtjen e konfidencialitetit.

Ky raport nxjerr rezultate të dobëta të llogaridhënies në fushën e shërbimeve sociale. Mandati ose roli i dyfishtë që MPMS ka për monitorim dhe inspektim paraqet një praktikë jo të mirë të procesit të monitorimit dhe inspektimit, andaj mund të konsiderohet edhe si një lloj konflikt interesit. Rezultatet e dobëta vijnë edhe nga fakti që inspektimi realizohet nga njësitë që vepron brenda ministrisë, mos pasja e kompetencave ekzekutive dhe mos aplikimi i masave, gjobave dhe sanksioneve. Fuqishëm rekomandohet që përmes Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare të ndahet funksioni i inspektimit dhe monitorimit, ku inspektimi duhet të bëhet nga niveli qendror, përkatësisht nga MPMS, përderisa monitorimi të bëhet nga niveli komunal. Po ashtu për këta trupa rekomandohet dhënia e kompetencave ekzekutive dhe zhvillimi i kapaciteteve të nevojshme për kryerjen e funksioneve të kërkuara. Gjithashtu, ky raport nxjerr që nuk ka një sistem të mirëfilltë monitorimi nga ana komunave, prandaj rekomandohet ngritja e kapaciteteve të komunave për monitorim.

Decentralizimi nënkupton ndryshim në kulturën institucionale, duke krijuar një kontekst socio-politik që çon në transferimin e autoritetit dhe transferimin e financimit nga qeveria qendrore në qeverinë lokale për të siguruar ofrim cilësor dhe efektiv të shërbimeve. Prandaj është e rëndësishme të sigurohet që interesat e popullsisë do të merren parasysh gjatë procesit të hartimit të politikave qendrore dhe zbatimit të tyre nga ana e autoriteteve lokale. Ky raport monitorimi tregon që decentralizimi nuk është ende pjesë e kulturës institucionale dhe vazhdon të trajtohet si një proces teknik.

Qëllimi

Raporti për monitorimin e procesit të decentralizimit të shërbimeve sociale në Kosovë, ka si objektiv kryesor prezantimin e gjendjes aktuale mbi zbatimin e plotë të këtij procesi. Duke u bazuar në të gjeturat e monitorimit, raporti synon të ofrojë rekomandime për përmirësimin e gjendjes aty ku vërehen mangësi. Të gjitha rekomandimet janë të mbështetura në dokumente, praktika ndërkombëtare dhe vendore, si dhe rekomandime të akterëve përgjegjës për zbatimin e procesit të decentralizimit.

Metodologjia e hartimit të raportit mbështetet në mbledhjen e të dhënave të bazuara në metodën cilësore që përfshin analizën teorike të legjislacionit primar dhe sekondar, publikimet si dhe hulumtimin në terren. Specifikisht, ky raport monitorimi bazohet në:

- Analizën e legjislacionit;
- Analizën e publikimeve relevante;
- Intervistat me përfaqësuesit relevantë në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare.

Metodologjia

Konkretisht, gjithsej janë realizuar 31 intervista në shtatë komuna të Kosovës. Intervistat janë realizuar me përfaqësues të nivelit qendror dhe komunal:

- Tre intervista me përfaqësues të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjes;
- Shtatë intervista me përfaqësues të Drejtorive për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në shtatë komuna të Kosovës;
- Shtatë intervista me përfaqësues të Qendrave për Punë Sociale në shtatë komuna të Kosovës;
- Nëntë intervista me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile.

Monitorimi është realizuar në shtatë komuna të Kosovës: Prishtinë, Prizren, Pejë, Ferizaj, Fushë Kosovë, Lipjan dhe Kamenicë.

Përzgjedhja e komunave është bërë për të:

- Siguruar mbulimin gjeografik të Kosovës;
- Përfshirë komunat me numër më të madh të banorëve dhe rrjedhimisht numër më të madh të rasteve sociale sikurse Komuna e Prishtinës, Prizrenit, Pejës, Ferizajit;
- Përfshirë komunat e vogla por me numër më të madh të problemeve sociale sikurse Komuna e Fushë Kosovës;
- Përfshirë komunat me numër më të madh të komuniteteve etnike në Kosovë, sikurse Komuna e Lipjanit dhe Kamenicës.

Mbulimi gjeografik



KORNIZA LIGJORE

Korniza ligjore

Decentralizimi i shërbimeve sociale është bërë në vitin 2009, ku janë bartur kompetencat nga niveli qendror (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale) drejt komunave të Kosovës. Qëllimi i decentralizimit të shërbimeve sociale ka qenë që këto shërbime të jenë sa më afër qytetarit.

Kalimi i menaxhimit të shërbimeve sociale nga niveli qendror në nivelin komunal është bërë në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit në mes të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrisë së Financave dhe komunave, të nënshkruar në vitin 2009. Por edhe pas dhjetë vitesh, procesi i decentralizimit po vazhdon të ketë sfida në zbatimin e plotë të tij. Shërbimet sociale në Kosovë rregullohen me Ligjin Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, Ligjin Nr. 04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale.

Sipas LSHSF, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është institucioni përgjegjës për të gjitha politikat, licencimin, monitorimin, inspektimin dhe çështjet rregullative në lidhje me punën dhe mirëqenien sociale. Ndërkaq sipas LVQL, komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare. Komunat kanë mandatin për të marrë përgjegjësinë mbi çështjet e mirëqenies sociale të tyre dhe bëjnë menaxhimin e Qendrave për Punë Sociale.

Ndërsa sa i përket financimit të shërbimeve sociale, sipas LFPL, ato financohen nga Granti i Përgjithshëm dhe të hyrat vetanake komunale.¹ Granti i Përgjithshëm ka për qëllim sigurimin e një burimi bazë për të mundësuar që komunat të kryejnë të gjitha funksionet e tyre. Granti i Përgjithshëm është grant i tipit të mbyllur me 10% të të hyrave të projektuara që do të duhen të mblidhen në nivel qendror gjatë një viti kalendarik. Mirëpo mënyra aktuale e financimit nuk garanton ndarje të mjaftueshme që të sigurohet minimumi i financimit për shërbimet sociale. Kjo për shkak se nuk ekziston ndonjë mekanizëm i ndarjes së financimit për shërbimet sociale duke ditur se nga këto shuma buxhetohen të gjitha departamentet për shpenzimet operative dhe kapitale brenda komunave.

Bazuar në legjislacionin në fuqi, shërbimet sociale dhe familjare përfshijnë mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve për personat në nevojë për mbrojtje sociale, duke përfshirë: fëmijët pa kujdes prindëror, fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët apo personat me aftësi të kufizuara, fëmijët apo të rriturit viktimat të abuzimit me substanca narkotike, viktimat e dhunës në familje, abuzimit, trafikimit dhe lënies pas dore, fëmijët e përfshirë në punë të rënda apo qytetarët në nevojë për shërbime sociale.

¹ Ligji për Financat e Pushtetit Lokal, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2525>



TË GJETURAT KRYESORE

Të gjeturat kryesore nga monitorimi i procesit të decentralizimit të shërbimeve sociale

Deri më tani në Kosovë ka munguar një proces i pavarur dhe i paanshëm i monitorimit të decentralizimit të shërbimeve sociale, prandaj nuk ka të dhëna për të bërë krahasimin me një periudhë paraprake.

Ky raport monitorimi vërteton që procesi i decentralizimit të shërbimeve sociale nuk është përmbyllur. Në gjithsej shtatë komuna në të cilat është bërë monitorimi i decentralizimit të shërbimeve sociale, në asnjë prej tyre nuk është zbatuar plotësisht ky proces.

Bazuar në të gjeturat e monitorimit, shërbimet sociale janë në gjendje shumë të rëndë dhe po përballen me sfida të shumta, përfshirë mungesën e mekanizimit për ndarjen e buxhetit për shërbime sociale, kapacitetet e kufizuara financiare dhe njerëzore, mungesën e shërbimeve sociale të nevojshme, paqartësi në ndarjen e përgjegjësisë në mes të nivelit qendror dhe komunal, konfuzionin rreth raportimit dhe komunikimit, llogaridhënien e ulët, ndarjen e roleve të monitorimit dhe inspektimit, mungesën e të dhënave statistikore mbi personat në nevojë për shërbime sociale si dhe mungesën e bashkëpunimit dhe komunikimit në nivel horizontal dhe vertikal.

Më poshtë janë të prezantuara arsyet dhe sfidat kryesore të cilat ndikojnë në mos zbatimin e procesit të decentralizimit.

Mungesa e vullnetit politik për zbatimin e decentralizimit të shërbimeve sociale

Bazuar në gjetjet e monitorimit, arsyeja kryesore e mos-zbatimit të procesit të decentralizimit është mungesa e vullnetit politik si nga ana e nivelit qendror, ashtu edhe nga ana e nivelit komunal. Sipas përfaqësuesve të MPMS, ky proces është konsideruar edhe si i imponuar dhe i nxituar për shkak se komunat e Kosovës nuk kanë qenë të gatshme dhe të përgatitura paraprakisht për zbatimin e këtij procesi. Zyrtarë të MPMS konsiderojnë që përveç kësaj, niveli i lartë i qeverisë deri më tani nuk e ka pasur asnjëherë prioritet ndryshimin e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal dhe zgjidhjen e problemit të financimit për shërbime sociale, pra decentralizimin e buxhetit për shërbime sociale, e cila konsiderohet si çështje kruciale për zbatimin e procesit të decentralizimit. Sipas Drejtorit të Departamentit të Politikave Sociale dhe të Familjes në MPMS, nuk ka vullnet as nga ana e komunave për të zbatuar procesin e decentralizimit.

Komunat e Kosovës nuk po i kryejnë përgjegjësitë e përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe po vazhdojnë të mos i trajtojnë me prioritet shërbimet sociale brenda komunës.²

Në anën tjetër, përfaqësues nga komunat konsiderojnë që niveli qendror ka dështuar në planifikimin e procesit të decentralizimit, pasi që ka bërë bartjen e kompetencave të shërbimeve sociale pa e zgjidhur problemin e financimit të shërbimeve sociale. Gjithashtu komunat konsiderojnë që edhe nga ana e nivelit komunal ka pasur neglizhencë në marrjen e përgjegjësi për menaxhimin e shërbimeve sociale pas decentralizimit dhe komunat janë të fokusuara kryesisht në infrastrukturë dhe ndërtim.³ Vështirësitë më të mëdha me të cilat DSHMS-të vazhdojnë të përballen, janë mungesa e priorizimit të shërbimeve sociale nga komunat apo kabineti i Kryetarit të Komunës. Kjo vjen si pasojë e faktit se shërbimet sociale konsiderohen nga komunat si shpenzim pa ndonjë përfitim. Në përgjithësi, gjatë monitorimit është vërejtur se komunat nuk kanë vizion për përfitimet afatgjata në investimin në shërbimet sociale.

Përfaqësues të OJQ-ve theksojnë mungesën e vullnetit dhe interesimit të komunave në mbështetjen e shërbimeve sociale. Sipas tyre, kjo dëshmohet me mos planifikimin e duhur të shërbimeve sociale nga ana e komunave, mungesën e ndarjes së buxhetit për shërbime apo kontraktim të shërbimeve si dhe mungesën e monitorimit të shërbimeve sociale.

Rekomandohet që institucionet përgjegjëse në nivel qendror dhe komunal të priorizojnë zbatimin e procesit të decentralizimit të shërbimeve sociale, duke konsideruar investimin në mirëqenie sociale si investim afatgjatë që sjell rezultate pozitive në shoqëri.

Mos zbatimi i decentralizimit të buxhetit për shërbime sociale

Ky raport konstaton se mungesa e decentralizimit të buxhetit për shërbime sociale ka shkaktuar një gjendje shumë të rëndë të ofrimit të këtyre shërbimeve. Forma e tanishme e financimit nuk siguron një mekanizëm të qëndrueshëm për financimin e shërbimeve sociale dhe kjo çështje është shndërruar në problem kritik ekzistencial për funksionimin e QPS-ve dhe Organizatave Jo-Qeveritare.

Aktualisht, nuk është bërë kostimi i shërbimeve (standardet financiare), nuk është hartuar formula e financimit për shërbime sociale dhe nuk është krijuar plani për financim të qëndrueshëm të shërbimeve sociale nga MPMS dhe Komunat, prandaj është e domosdoshme që të ndërhyhet nga të dy nivelet: qendror dhe komunal (MPMS dhe Komuna) deri në sigurimin e një zgjidhjeje të qëndrueshme të financimit të shërbimeve sociale, krijimin dhe aplikimin e Grantit Specifik për Shërbime Sociale.

² Intervistë me Mentor Morina, Drejtor i Departamentit për Politikë Sociale dhe Familjare, MPMS, 04.07.2019

³ Intervistë me Bekim Ademi, Drejtor në DSHMS Ferizaj, 05.06.2019

a) *Financimi aktual i shërbimeve sociale nga MPMS*

Në vitin 2019, buxheti total i MPMS ishte 466.7 milionë Euro, ku pjesa dërmuese është ndarë për skema dhe transfere, përkatësisht 453.2 milionë Euro apo 97,7% e buxhetit të kësaj ministrie. Skemat mbulojnë pensionet bazike-sociale dhe kontribut-dhënëse, pensionet e veteranëve, invalidëve të luftës, pensionet e aftësisë së kufizuar, kompensimi për të burgosurit politik, pensionet e parakohshme (Trepça) etj.⁴

Në kuadër të skemave, MPMS ka ndarë 3 milionë Euro për skemën dhe Përkrahje Materiale Familjeve që kanë Fëmijë me Aftësi të Përhershme të Kufizuara: 800,000 Euro për Programin e Strehimit familjar brenda familjes biologjike dhe jashtë familjes biologjike. Përderisa, 29 milionë Euro të transfereve janë të dedikuara për Skemën e Asistencës Sociale për familjet në varfëri, ku përfitues janë edhe fëmijët. Bazuar në të dhënat e mësipërme, vërtetohet se aktualisht në Kosovë, MPMS përkrahjen sociale e ka të orientuar drejt ndihmës monetare mujore në kuadër të skemave sociale.

Megjithëse buxheti për MPMS ka pasur rritje në vitin 2019, buxheti i ndarë për shërbime sociale vazhdon të jetë shumë i ulët. Konkretisht, nga totali i buxhetit të MPMS 466.7 milionë Euro, MPMS në kuadër të shërbimeve sociale ka ndarë 2 milionë Euro për Shtëpinë e personave të moshuar, Institutin Special në Shtime dhe Shtëpinë e bazuar në komunitet në Shtime për fëmijët me aftësi të kufizuara pa përkujdesje prindërore dhe 200,000 Euro për strehimoren shtetërore për viktimat e trafikimit me qenie njerëzore.⁵

MPMS përmes procesit të thirrjeve publike, ka ndarë 900,000 Euro për financimin e shërbimeve sociale direkte të ofruara nga sektori jo-qeveritar.

Shuma maksimale e mbështetjes financiare, për një OJQ mund të jetë nga 10,000 - 40,000 euro për projekt (rajonal apo nacional). Kohëzgjatja për zbatimin e aktiviteteve të projekt propozimit është dhjetë (10) muaj. Megjithatë, kjo mbështetje mbulon vetëm një pjesë të kostos së shërbimeve, prandaj rezulton të jetë e pamjaftueshme duke pasur parasysh buxhetin e nevojshëm për shërbimet e ofruara. Në anën tjetër, gjatë muajve Janar – Mars 2019 ka pasur zbrazëti kohore mes thirrjeve për financim të shërbimeve nga MPMS, gjë që ka pamundësuar funksionimin e shërbimeve në mënyrë të qëndrueshme. Si pasojë, pothuajse çdo vit ofruesit e shërbimeve nga sektori jo-qeveritar detyrohen të mbyllin përkohësisht shërbimet duke u obliguar të lëvizin fëmijët përfitues të shërbimeve nga një formë e kujdesit në një formë tjetër, gjë që përbën shkelje të rëndë të të drejtave të fëmijëve dhe ndikon në mënyrë negative në zhvillimin e tyre fizik dhe psikologjik.

Në total, në kuadër të shërbimeve sociale MPMS ka ndarë rreth 3 milionë Euro.

..... Vlen të përmendet që MPMS gjatë 2019 nuk ka ndarë buxhet për institucionet publike për ofrimin e shërbimeve sociale në nivel komunal, sikurse janë QPS-të.

⁴ Platforma buxhetore, Instituti GAP, <https://institutigap.org/spendings/?ministra-e-punes-dhe-mireqenies-sociale/1/2019>

⁵ Të dhënat nga Departamenti për Politika Sociale dhe Familjare, MPMS

Buxheti për shërbime sociale 2019 - MPMS

99% Buxheti total



1% Buxheti për shërbime sociale



Figura1: Buxheti i ndarë për shërbime sociale nga MPMS për vitin 2019

b) *Financimi aktual i shërbimeve sociale nga komunat*

Financimi total nga Granti i Përgjithshëm për vitin 2019, për të gjitha QPS-të dhe për të gjitha kategoritë, e shpenzimeve ka qenë rreth 6 milionë Euro, ku janë përfshirë kostot e pagave të stafit të QPS-ve dhe shpenzimet e tjera operative. Ndërkaq, kostoja e financimit të shtëpive rezidenciale për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara për vitin 2019, ka qenë rreth 1.7 milionë Euro.

Ky raport monitorimi tregon se komunat mbulojnë vetëm pagat mujore dhe shpenzimet administrative për shërbimet sociale. Në përgjithësi, komunat nuk ndajnë buxhet për QPS-të për ofrimin e shërbimeve sociale të bazuar në nevojat e qytetarëve brenda komunave. E vetmja komunë që ka bartur një fond emergjent të veçantë vetëm për ofrimin e shërbimeve sociale drejt QPS, është Komuna e Lipjanit. Për më tepër komunat nuk marrin për bazë faktorët si numrin e popullsisë, grupmoshat, nevojat e komunës për shërbime sociale, aq më pak marrin për bazë faktorët e rrezikut të tillë si nivelin e varfërisë, papunësisë etj.

Në anën tjetër, komunat nuk kanë krijuar një skemë të qëndrueshme të kontraktimit për blerjen e shërbimeve sociale nga sektori jo-qeveritar. Mbështetja e komunave mbetet ad hoc dhe varion nga komuna në komunë. Megjithatë, krahasuar me raportet e viteve të kaluara të komunave, vërehet një përmirësim i lehtë sa i përket kontraktimit të shërbimeve sociale të sektorit jo-qeveritar.

Më poshtë janë paraqitur shumat e ndara për kontraktimin e shërbimeve sociale nga komunat.



KOMUNA E PRISHTINËS

përmes thirrjes publike për mbështetje financiare të projekteve të OJQ-ve për shërbime sociale për vitin 2019, ka ndarë shumën prej 59,650 Euro për 18 organizata ofruese të shërbimeve sociale në komunën e Prishtinës. Vlera e buxhetit të ndarë për një organizatë varion nga 500 deri në 6,200 Euro.



KOMUNA E PRIZRENIT

për vitin 2019 ka shpallur një thirrje publike për OJQ-të për ofrimin e shërbimeve sociale. Në këtë thirrje kanë aplikuar 12 OJQ ku 11 prej tyre kanë përfituar në shumën prej 26,100 Euro të ndarë në mënyrë proporcionale, përafërsisht janë ndarë nga 2,500 Euro për secilën OJQ.⁶



KOMUNA E LIPJANIT

ka ndarë 1,500 Euro për QPS-të nga kodi buxhetor mallra dhe shërbime, përderisa përmes thirrjes publike për subvencionim të OJQ-ve me qëllim të ofrimit të shërbimeve sociale, ka ndarë 5,000 Euro për një OJQ. Gjithashtu përveç thirrjes publike, nga Zyra e Kryetarit brenda vitit 2019 janë subvencionuar edhe tri OJQ të tjera në vlerë prej 1,600 Euro.⁷



KOMUNA E FERIZAJIT

ka ndarë gjithsej 813,125 Euro për OJQ-të që ofrojnë shërbime sociale. Në formën e subvencioneve ajo ka mbështetur 10 OJQ për shërbime sociale në shumën totale prej 13,125 Euro. Vlera e mbështetjes për një organizatë varion nga 375 Euro deri në 2,000 Euro. Ndërkaq në faqen zyrtare të Komunës së Ferizajit figuron që kjo komunë përmes shpalljes së tenderit, ka kontraktuar vetëm një organizatë për kryerjen e shërbimeve sociale dhe shëndetësore, në vlerën prej 800,000 Euro.⁸



KOMUNA E KAMENICËS

për vitin 2019 nuk ka shpallur asnjë thirrje publike për kontraktimin e shërbimeve sociale nga OJQ-të. Komuna e Pejës nuk ka ofruar informacion për ndarjen e buxhetit për kontraktimin e shërbimeve nga sektori jo-qeveritar. Përderisa Komuna e Fushë Kosovës ka ofruar të dhënat për numrin e OJQ-ve të financuara gjatë 2019 (6 OJQ), por nuk ka ofruar të dhëna për shumën e ndarë për këto OJQ.⁹

Nëse vazhdohet me këtë formë të financimit nga niveli komunal dhe qendror, gjendja mund të keqësohet për aq sa ta sjellë QPS-të dhe sektorin jo-qeveritar në qendra jofunksionale, të cilat duke mos u financuar mjaftueshëm nuk do të mund të ofrojnë shërbime sociale.

6 Të dhëna nga Fejzë Kabashi, DSHMS në Prizren, 2020

7 Intervistë me Vlora Limani Hajnuni, Drejtoreshë e DSHMS në Lipjan, 28.05.2019

8 Të dhëna nga Bekim Ademi, DSHMS në Ferizaj, 2020

9 Të dhëna nga Kimete Kryeziu, DSHMS në Kamenicë, 2020

c) *Krijimi i skemës së qëndrueshme për kontraktimin e shërbimeve sociale nga komunat*

Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare në Kosovë ka përcaktuar rolin e OJQ-ve në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, duke theksuar se OJQ-të inkurajohen të ofrojnë shërbime sociale dhe familjare, qoftë me iniciativën e tyre ose me kontratë, në emër të DSHMS-ve ose MPMS-së.

Në këtë linjë, komunat kanë dështuar në krijimin e një skeme të qëndrueshme të kontraktimit të OJQ-ve që ofrojnë shërbime sociale, duke u bazuar në standardet minimale të miratuara nga MPMS, kështu kanë çenuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve por edhe interesimin e OJQ-ve për të vepruar në komuna.

Ky monitorim nxjerr se të gjitha komunat e monitoruara ndajnë fonde për ofruesit e shërbimeve sociale kryesisht në formë të subvencioneve dhe jo në formën e blerjes së shërbimeve, e cila do të ishte skemë shumë më e përshtatshme dhe më e qëndrueshme për natyrën e ofrimit të shërbimeve sociale. Konkretisht, nga nëntë organizata të shoqërisë civile, pesë prej tyre kanë deklaruar që komunat hapin shpallje publike për financimin e OJQ-ve, por vetëm në formë të subvencioneve dhe jo për kontraktim të shërbimeve. Për më tepër, në këto thirrje shpesh herë nuk ka kriteret specifike për kategori të caktuara, duke ju dhënë mundësi aplikimi secilës organizatë pavarësisht shërbimeve apo fushës së veprimt. ¹⁰ Po ashtu thirrjet për ofrimin e shërbimeve sociale janë shpesh herë të përgjithshme dhe nuk janë të bazuara në nevojat e komunës, duke qenë se asnjë nga komunat nuk ka bërë një vlerësim të nevojave të qytetarëve brenda komunës së tyre. Thirrjet e komunave duhet të kenë kriteret specifike për kategori të caktuara dhe duhet të përmbajnë elemente të standardeve minimale për ofrim të shërbimeve sociale.

Gjatë monitorimit janë shqyrtuar kërkesat dhe kriteret në kuadër të thirrjeve të shpallura nga komunat për ofrimin e shërbimeve nga sektori jo-qeveritar. Bazuar në këtë monitorim, shpalljet nuk përmbajnë kërkesën që OJQ-të duhet të jenë të licencuara nga MPMS për ofrimin e shërbimeve sociale, si pasojë edhe ndarja e buxhetit është bërë edhe për organizatat e pa licencuara nga MPMS. Kriteri për licencim duhet të jetë kriteri kyç për kontraktimin e OJQ-ve nga komunat, duke qenë se organizatat e licencuara i janë nënshtruar paraprakisht një procedure të vlerësimit të kushteve dhe kriterëve nga MPMS të parapara me Udhëzimin Administrativ për Licencimin e Subjekteve Juridike/Organizatave që Ofrojnë Shërbime Sociale dhe Familjare.

Po ashtu, shuma totale e ndarë nga një komunë për subvencionimin e të gjitha OJQ-ve për ofrimin e shërbimeve sociale varion nga 10,000 – 60,000 Euro në vit, e cila kryesisht ndahet proporcionalisht pothuajse për të gjitha organizatat që aplikojnë. Kjo formë e financimit nga komunat ngjan më shumë në një mbështetje simbolike dhe sipërfaqësore për OJQ-të duke mos u bazuar në nevojat e komunës, kriteret, kërkesat dhe standardet. Forma e tillë e financimit çënon tregun e konkurrencës dhe vlerave mes OJQ-ve duke dëmtuar cilësinë e shërbimeve sociale. Përfaqësuesit e OJQ-ve konsiderojnë që komunat nuk bëjnë planifikim për organizimin e shërbimeve sociale dhe nuk e kanë të zhvilluar mënyrën e konkurimit dhe financimit. ¹¹

¹⁰ Intervistë me Naser Lajqi, OJQ Syri i Vizionit në Pejë, 05.08.2019

¹¹ Intervistë me Gani Lluga, OJQ ASTRA në Prishtinë, 28.06.2019

Bazuar në procesin e monitorimit, OJQ-të ofruese të shërbimeve sociale përballen me probleme të ngjashme si QPS-të, ku hyjnë mungesa e kapaciteteve financiare e njerëzore, problemet logjistike siç janë objektet ku operojnë dhe qëndrueshmëria e ofrimit të shërbimeve. Nga nëntë organizatat e intervistuar, shumica prej tyre financohen nga donatorë jo-qeveritar, ndërkaq ato pak organizata që kanë marrë ose janë duke marrë fonde nga komunat ose MPMS, deklarojnë se këto janë fonde të pamjaftueshme për të ofruar shërbime. Sipas përfaqësuesit të organizatës “Autizmi”, me 1,500 Euro sa ndahen nga komuna, fëmijët që trajtohen në këtë organizatë mund të marrin terapi vetëm për një muaj.¹² Sektori jo-qeveritar, po i sheh komunat si institucione që po neglizhojnë shërbimet sociale, duke mos investuar në staf e as në cilësi të shërbimeve sociale.¹³

Për të siguruar shërbime cilësore sociale dhe familjare, rekomandohet që komunat të krijojnë një skemë të qëndrueshme për kontraktimin e shërbimeve sociale dhe familjare nga sektori joqeveritar. Duke qenë se subvencionimi nuk siguron qëndrueshmëri në ofrimin e shërbimeve, komunat duhet të praktikojnë blerjen e shërbimeve sociale për periudhë afatgjatë përmes kontraktimit të QJQ-ve të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale.

Në shumicën e shteteve, komunat transferojnë shërbimet sociale në sektorin jo-qeveritar. Në Europë organizatat e shoqërisë civile po luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm, duke u bërë ofrues të shërbimeve sociale. Sipas studimit për sistemet e mbrojtjes së fëmijëve, të bërë nga Agjencia e Bashkimit European për të Drejtat të Njeriut, në të paktën 18 shtete (Austria, Bullgaria, Kroacia, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Gjermania, Hungaria, Irlanda, Italia, Letonia, Lituania, Malta, Holanda, Spanja, Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar) komunat kontraktajnë shërbimet sociale nga sektori jo-qeveritar.¹⁴ Kontraktimi i shërbimeve nga sektori jo-qeveritar është dëshmuar të ketë kosto më efektive për komunat si dhe garanton cilësi më të lartë të shërbimeve.

d) Krijimi i Grantit Specifik për Shërbime Sociale

Në vitin 2019 ka pasur lëvizje pozitive lidhur me rregullimin e kornizës ligjore për financimin e shërbimeve sociale. Pas shumë vitesh përpjekje nga institucionet dhe OJQ-të për krijimin e një Granti Specifik për Shërbime Sociale, MPMS dhe MeF janë dakorduar për krijimin e këtij Granti në kuadër të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal.

Konkretisht, Qeveria e Kosovës ka miratuar Koncept Dokumentin për hartimin e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, i cili i hap rrugë krijimit të Grantit Specifik për Shërbime Sociale. Përkundër kërkesave të shoqërisë civile që Granti Specifik të jetë i llojit të mbyllur, si alternativë më adekuate për sigurimin e një minimumi të ofrimit të shërbimeve sociale, sipas koncept dokumentit të aprovuar, Granti Specifik për Shërbime Sociale – parashihet të jetë grant me sistem të hapur.

¹² Intervistë me Flori Jupa, OJQ “Autizmi” në Prizren, 11.06.2019

¹³ Intervistë me Rexhep Gojnovci, OJQ Akti në Fushë Kosovë, 10.06.2019

¹⁴ Hartëzimi i sistemeve për mbrojtjen e fëmijëve në EU, Agjencia e Bashkimit European për të Drejtat të Njeriut <https://fra.europa.eu/en/project/2014/mapping-child-protection-systems-eu>

Bazuar në Koncept Dokumentin e miratuar, gjatë vitit 2019 është hartuar Ligji i ri për Financat e Pushtetit Lokal ku është paraparë krijimi i Grantit Specifik për Shërbime Sociale. Projektligji ka kaluar fazën e konsultimeve publike, megjithatë për shkak të rënies së Qeverisë dhe shpërbërjes së Kuvendit, projektligji nuk është miratuar akoma nga Qeveria dhe Kuvendi.

Sipas këtij projektligji vlera e Grantit Specifik për Shërbime Sociale përcaktohet duke marrë parasysh faktorët/kriteret në territorin e një komune sikurse numrin e qendrave për punë sociale, numrin e qendrave rezidenciale dhe numrin e qendrave ditore sipas standardeve të përcaktuara nga niveli qendror, numrin e punëtorëve social në përpjesëtim me numrin e banorëve dhe numrin e rasteve, numrin e fëmijëve në bazë të grup-moshave dhe të rriturve të cenuar apo rrezikuar; numrin e viktimave të dhunës në familje, trafikimit dhe abuzimit, numrin e personave me nevoja të veçanta sipas shkallës së pa- aftësisë, numrin e personave të moshuar mbi moshën 65 vjeç dhe numrin e familjeve në asistencë sociale në relacion me sipërfaqen e territorit komunal.¹⁵

Po ashtu gjatë vitit 2019, MPMS me vendim ka krijuar një grup punues për hartimin e formulës së financimit për shërbime sociale, formulë kjo mbi të cilën do të bazohet shuma e buxhetit të ndarë në kuadër të Grantit Specifik për Shërbime Sociale. Drejtori i Departamentit për Politika Sociale dhe të Familjes, ka treguar që MPMS gjatë vitit 2019 ka punuar në nxjerrjen e kostove për njësi lidhur me shërbimet sociale, duke përfshirë shërbimet ditore dhe ato rezidenciale. Mbetet që grupi punues në kuadër të MPMS të punojë për nxjerrjen e një dokumenti referues për udhëzimin administrativ për formulën e financimit.¹⁶

Sipas Drejtorit të DPSF, shuma totale e shpenzimeve aktuale për të gjitha kategoritë e shpenzimeve për QPS-të dhe financimin e institucioneve rezidenciale, është rreth 10 milionë Euro. Ndërsa MPMS kërkon që në vitin e parë të zbatimit të Ligjit të ri për Financat e Pushtetit Lokal shuma totale e ndarë përmes Grantit Specifik të jetë 15 milionë Euro, që i bie që buxheti për shërbime sociale të rritet për 5 milionë Euro.

Bazuar në monitorim, përfaqësuesit e MPMS, DSHMS-ve, QPS-ve dhe OJQ-ve, besojnë që me anë të një Granti Specifik për Shërbime Sociale, problemi i buxhetit për shërbime sociale do të rregullohet.

Sipas Drejtorit të DSHMS në Ferizaj, Granti Specifik për Shërbime Sociale do të ishte një ndër parakushtet për kompletimin e procesit të decentralizimit. Megjithatë, ai shprehet që ky Grant nuk do ta rregullojë në tërësi problemin e financimit, duke qenë se me krijimin e Grantit nuk pritet të ketë dyfishim apo trefishim të buxhetit, përkundër nevojave shumë të mëdha për shërbime.¹⁷

Drejtori i DSHMS në Prizren është shprehur që Granti Specifik do ti hapte rrugë rregullimit të financimit të shërbimeve sociale, megjithatë ai shton që çështja e financimit të shërbimeve sociale mund të përmirësohet edhe me vullnetin dhe përkrahjen e kryetarit të komunës.¹⁸

Mirëpo, Drejtoresha e DSHMS në Lipjan nuk e sheh si efektiv krijimin një Granti me sistem të hapur, ashtu siç është paraparë në Koncept Dokumentin për Financat e Pushtetit Lokal, ajo rekomandon Grantin Specifik për Shërbime Sociale të llojit të mbyllur. Sipas saj, Granti i hapur do tu krijojë

¹⁵ Projektligji për Financat e Pushtetit Lokal, <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=40711>

¹⁶ Intervistë me Mentor Morina, Drejtor i Departamentit për Politika Sociale dhe Familjare, MPMS, 04.07.2019

¹⁷ Intervistë me Bekim Ademi, Drejtor në DSHMS në Ferizaj, 05.06.2019

¹⁸ Intervistë me Fejzë Kabashi, Drejtor në DSHMS në Prizren, 11.06.2019

mundësi komunave që sërish ta orientojnë këtë Grant për çështje të tjera, duke mos e detyruar komunën që Grantin ta drejtojë vetëm për shërbime sociale. Zgjidhja e vetme sipas saj është Granti Specifik me sistem të mbyllur, i cili do t'i detyronte komunat që këtë Grant ta shfrytëzojnë vetëm për shërbime sociale.¹⁹

..... Ndërkohë që sipas Drejtorit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e
..... Pejës, së pari duhet të fillohet me bartjen e kompetencave në nivel komunal, pra
..... në komuna, mirëpo edhe Granti Specifik është i nevojshëm.²⁰

Duke pasur parasysh faktin që Granti Specifik për Shërbime Sociale për shkak të procedurave ligjore nuk pritet të aplikohet gjatë vitit 2021 dhe 2022, rekomandohet që gjatë kësaj periudhe MPMS dhe Komunitat të ndërmarrin veprime urgjente duke ndarë buxhet për sigurimin e financimit të shërbimeve sociale. Bazuar në të gjeturat e monitorimit, rekomandohet që Ligji i ri për Financat e Pushtetit Lokal të miratohet në mënyrë që të sigurohet financim i qëndrueshëm për shërbimet sociale përmes Grantit Specifik për Shërbime Sociale. Ky Grant duhet të jetë i bazuar në standardet minimale të MPMS, formulën e financimit të shërbimeve sociale si dhe kriteret dhe indikatorët social në komuna.

e) *Kapacitetet e komunave dhe Qendrave për Punë Sociale për planifikim dhe menaxhim të buxhetit për shërbime sociale*

Ky raport tregon se komunat dhe QPS-të nuk bëjnë planifikim buxhetor të mirëfilltë në baza vjetore, për shërbime sociale. Aktualisht planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit për shërbime sociale në komuna bëhet nga DSHMS. Planifikimi buxhetor i komunave është i prirur të përsërisë planifikimet buxhetore paraprake, pa ndonjë vlerësim mbi nevojat e qytetarëve për shërbime sociale. Për më tepër, ky planifikim nuk merr për bazë as nevojat e QPS-ve dhe OJQ-ve ofruese të shërbimeve sociale në komuna.

Ndërsa, QPS-të ende nuk kanë arritur të hartojnë ndonjë planifikim të rregullt vjetor për nevojat dhe shërbimet sociale që ofrohen gjatë vitit. Në të shumtën e rasteve, zyrtari financiar së bashku me drejtorin e QPS-së, hartojnë kërkesa me nevojat e QPS-së duke i adresuar ato në DSHMS.

Kryesisht kërkesat e hartuara nga QPS drejt DSHMS janë ad hoc dhe kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e objekteve, çështjet administrative, logjistike dhe jo me shërbime. Në anën tjetër, edhe në rast të kërkesave të QPS-ve, buxheti i ndarë për këto qendra menaxhohet nga DSHMS dhe nuk bartet në QPS.

Ndryshimet ligjore dhe politikat e MPMS janë të orientuara që pas krijimit të Grantit Specifik për Shërbime Sociale dhe formulës së financimit, buxheti i dedikuar për shërbime sociale duhet të bartet nga komunat tek QPS-të. Konkretisht, pritet që QPS-të të menaxhojnë vetë me buxhetin për shërbime sociale. Arsyeja është se rastet e trajtuara nga QPS-të kërkojnë ndërhyrje emergjente prandaj është e nevojshme që të eliminohen procedurat burokratike për të mos shkaktuar vonesa gjatë trajtimit të rasteve. Sipas përfaqësuesve të

¹⁹ Intervistë me Vlorë Limani Hajnuni, Drejtoreshë e DSHMS në Lipjan, 28.05.2019

²⁰ Intervistë me Petrit Loci, Drejtor i DSHMS në Pejë, 24.06.2019

QPS-ve, nuk janë të pakta rastet kur zyrtarët e shërbimeve sociale paguajnë nga të ardhurat e tyre personale për nevojat emergjente të rasteve dhe sidomos të fëmijëve. Ata tregojnë shembuj të ndryshëm të rasteve të tilla, siç janë blerja e qumështit apo veshmbathjeve për fëmijët e braktisur apo sigurimi i ushqimit për fëmijët viktimë gjatë kohës së intervistimit në stacionet policore.²¹

Qendrat për Punë Sociale konsiderojnë që para Memorandumit të Mirëkuptimit për decentralizimin e shërbimeve sociale, ofrimi i shërbimeve sociale dhe buxheti i alokuar për QPS-të ka qenë në gjendje më të mirë se sa gjendja aktuale.²² Si pasojë e mos-zbatimit të decentralizimit të buxhetit për shërbime sociale, QPS-të po përballen edhe me mungesën e një fondi emergjent i cili do të menaxhohej nga vetë ato dhe i cili konsiderohet i domosdoshëm për natyrën e punës që kanë QPS-të. Përfaqësues të QPS-ve, kanë pohuar që para decentralizimit kanë pasur edhe fond emergjent, i cili tani mungon në shumicën e komunave.²³ Nga shtatë komunat e monitoruara, është identifikuar vetëm një komunë e cila ka ndarë dhe ka bartur një buxhet të caktuar për shërbime sociale drejt Qendrës për Punë Sociale në mënyrë që QPS të menaxhojë vetë me këtë buxhet.

Megjithatë, edhe pse Drejtoria Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Lipjan e ka bartur buxhetin e caktuar për shërbime sociale në QPS në Lipjan në fillim të vitit 2019, kjo e fundit ka qenë e papërgatitur për menaxhimin dhe shfrytëzimin e këtij buxheti. Në vend që këto mjete të shfrytëzohen për shërbime sociale, QPS ka bërë kërkesë drejt komunës që këtë buxhet ta shfrytëzojë për mirëmbajtje të objektit. Drejtoresha e QPS-së në Lipjan ka pranuar që janë të papërgatitur sa i përket planifikimit dhe menaxhimit buxhetor për shërbime sociale dhe në të njëjtën kohë ka shprehur nevojën për ngritjen e kapaciteteve në këtë drejtim.²⁴

Edhe pse të gjitha QPS-të e monitoruara kanë në përbërje të tyre pozitën e financierit, vetë fakti që ata nuk menaxhuan asnjëherë buxhet prej 10 vitesh tashmë, tregon që ata kanë nevojë për ngritje të kapaciteteve. Po ashtu rasti i QPS në Lipjan, është edhe një shembull që QPS-të nuk janë të gatshme të menaxhojnë buxhet për shërbime sociale. Kjo tregon se këto institucione nuk kanë qenë dhe vazhdojnë të mos jenë të përgatitura për pranim të kompetencave për menaxhimin e buxhetit të tyre.

Ky raport tregon që QPS-të nuk janë të përgatitura për planifikim dhe menaxhim të buxhetit për shërbime sociale, prandaj rekomandohet që paraprakisht të ngrihen kapacitetet brenda QPS-ve për planifikim dhe menaxhim të buxhetit. Duke pasur parasysh mungesën e kapaciteteve brenda QPS-ve, rekomandohet që ato të përgatiten për pranim të kompetencave për planifikim dhe menaxhim të buxhetit për ofrimin e shërbimeve sociale. Gjithashtu, QPS-të duhet të zhvillohen për të bërë planifikim të rregullt buxhetor bazuar në nevojat e qytetarëve në komunat e tyre.

21 Intervistë me Abaz Xhigoli, Drejtor, QPS në Fushë Kosovë, 18.06.2019

22 Intervistë me Naime Azemi, Zyrtare e Shërbimeve Sociale, QPS në Prishtinë, 27.05.2019

23 Intervistë me Ruzhdi Latifi, Drejtor, QPS në Ferizaj, 05.06.2019

24 Intervistë me Vlora Limani Hajnuni, Drejtoreshë e DSHMS në Lipjan dhe Makfirete Shamolli, Drejtoreshë në QPS në Lipjan, 28.05.2019

Paqartësitë sa i përket kompetencave të institucioneve për shërbime sociale

Bazuar në këtë monitorim, është parë që rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve të nivelit qendror dhe komunal në Kosovë nuk janë të definuara mirë. Institucionet e të dyja niveleve vazhdojnë të kenë paqartësi në përgjegjësitë e tyre lidhur me shërbimet sociale. Konkretisht paqartësitë lidhen me raportimin, monitorimin dhe komunikimin.

Gjatë monitorimit është vënë re që paqartësitë rreth kompetencave mes dy niveleve më së shumti kanë dëmtuar ofruesit e shërbimeve sociale. Ata kanë pohuar se ende ekzistojnë paqartësi në ndarjen e detyrave, kompetencave dhe përgjegjësi në mes të nivelit qendror dhe komunal.

Nga shtatë QPS-të e monitoruara, katër prej përfaqësuesve kanë deklaruar se përgjegjësitë e dy niveleve nuk janë ende të qarta. Ndërkaq njësoj mendojnë edhe përfaqësues nga DSHMS dhe OJQ.

a) *Raportimi*

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është institucioni përgjegjës për të gjitha politikat dhe çështjet rregullative në lidhje me punën dhe mirëqenien sociale. Ndërkaq, komunat kanë përgjegjësinë të ofrojnë shërbime sociale, në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare.

Raportimi i ofruesve të shërbimeve sociale nuk është ende i definuar dhe as i qartë as për komunat e as për QPS-të. Linja dhe mënyra e raportimit të ofruesve të shërbimeve sociale vazhdon të bëhet pa protokoll, pa format të caktuar të raportimit dhe lloji i raportimit varion nga komuna në komunë.

Qendrat për Punë Sociale dërgojnë dy lloje të raporteve, njërin për MPMS dhe tjetrin për DSHMS. QPS-të vazhdojnë të dërgojnë të dhënat e detajuara mbi rastet e trajtuara në baza mujore në MPMS. Mënyra e dërgimit të këtyre të dhënave në MPMS mbetet shqetësuese, duke qenë se QPS-të, dërgojnë këto të dhëna fizikisht përmes USB-ve, duke rrezikuar konfidencialitetin e rasteve të trajtuara. Ndër të tjera, baza e të dhënave për shërbime sociale e menaxhuar nga MPMS vazhdon të mos jetë e digjitalizuar. Përderisa në DSHMS, QPS-të dërgojnë raporte të tjera të përgjithshme rreth punës së tyre. Kjo krijon konfuzion tek QPS-të, të cilat nuk e kanë të qartë për llojet e raporteve që duhet dërgohen në DSHMS. Përveç të tjerash, gjatë monitorimit përfaqësues të QPS-ve kanë pohuar se nuk ka protokolle apo formate të caktuara për raportimin e punës tek komunat.

Në anën tjetër, zyrtarët nga DSHMS kanë deklaruar që raportet e njëjta me të dhënat e detajuara për rastet të cilat dërgohen në MPMS do të duhej të dërgohen edhe në DSHMS. Madje përfaqësues nga DSHMS

Lipjan kanë theksuar që raportimi i QPS-ve tek MPMS, duhet të bëhet përmes DSHMS.²⁵ Por kjo është kundërshtuar nga ana e QPS-ve të cilat hezitojnë të ndajnë raportet e detajuara me komunat për shkak të ruajtjes së konfidencialitetit të rasteve të trajtuara.

Në shumicën e komunave të monitoruara, të intervistuarit pohojnë se ekziston një hendek i madh komunikimi në mes të nivelit komunal dhe atij qendror (DSHMS – MPMS). Aktualisht, nuk ekziston ndonjë ndërlidhje e komunikimit dhe raportimit në mes të DSHMS – MPMS.²⁶

Edhe nga ana e nivelit qendror, mendojnë që mënyra e raportimit nuk është rregulluar ende dhe ky proces vazhdon të shkaktojë paqartësi në institucione. Sipas Drejtorit të Departamentit për Politika Sociale dhe Familjare në MPMS, ky mos-definim i përgjegjësive ka rezultuar në mos evidentimin e saktë të rasteve sociale dhe mos përcjellje të procesit në tërësi.²⁷

Sa i përket raportimit të ofruesve nga sektori jo-qeveritar, OJQ-të kanë deklaruar se nuk ekziston ndonjë linjë e raportimit as në nivelin komunal dhe as qendror në rastet kur nuk financohen nga institucionet publike. Në të shumtën e rasteve, përfaqësues nga OJQ-të ofruese të shërbimeve sociale, gjatë monitorimit kanë deklaruar që financohen nga donatorë jo-qeveritarë, prandaj raportimi bëhet vetëm ndaj donatorëve.

Rekomandohet definimi i rolit dhe përgjegjësive të institucioneve të nivelit qendror dhe komunal për të shmangur paqartësitë lidhur me raportimin dhe komunikimin. Rekomandohet rregullimi i raportimit në nivel horizontal dhe vertikal, standardizimi i formave të raportimit dhe ndarjes së të dhënave duke patur parasysh ruajtjen e konfidencialitetit.

b) Monitorimi dhe inspektimi i shërbimeve sociale

Me Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare, mandati për monitorimin dhe inspektimin e shërbimeve sociale mbetet në kompetencë të Departamentit për Politika Sociale dhe të Familjes (DPSF) në kuadër të MPMS-së. Mirëpo kjo praktikë rezulton të jetë e papërshtatshme dhe jo efektive. Praktikant ndërkombëtare tregojnë se monitorimi dhe inspektimi i ofruesve të shërbimeve sociale duhet të ndahet dhe të bëhet nga dy trupa të ndryshëm. Monitorimi duhet të bëhet nga niveli komunal, ndërsa inspektimi duhet të bëhet nga niveli qendror. Rekomandohet që Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare të ndajë këto dy funksione në mes të nivelit qendror dhe komunal.

Ky raport nxjerr rezultate të dobëta të llogaridhënies në fushën e shërbimeve sociale. Mandati ose roli i dyfishtë që MPMS ka për monitorim dhe inspektim paraqet konflikt të pastër interesi pasi në shumë prej rasteve kjo njësi bën monitorim dhe inspektim të vetvetes. Për më shumë monitorimi dhe inspektimi duhen parë si dy procese të ndryshëm dhe të ndarë nga njëri tjetri. Rezultatet e dobëta vijnë edhe nga fakti që inspektimi realizohet nga njësi që vepron brenda ministrisë, nga mos pasja e kompetencave ekzekutive dhe mos shqiptimi i masave, gjobave dhe sanksioneve.

25 Intervistë me Makfirete Shamolli, Drejtoreshë në QPS në Lipjan, 28.05.2019

26 Intervistë me Rifat Hajdari, Drejtor në QPS në Kamenicë, 25.06.2019

27 Intervistë me Mentor Morina, Drejtor i Departamentit për Politika Sociale dhe Familjare, MPMS, 04.07.2019

Sipas Zyrtares së Lartë për Monitorim dhe Inspektim në MPMS, nuk ekzistojnë pengesa për inspektim nga ana e DSHMS-ve, mirëpo problemi qëndron në zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga kjo njësi për ofruesit e shërbimeve sociale. Kjo ndodh për shkak të mos-definimit të rolit të inspektimit, ku njësi për inspektim nuk ka asnjë mandat ekzekutiv.²⁸ Përveç kësaj, Njësia për Inspektim përballet edhe me probleme tjera të funksionimit, siç janë numri i vogël i zyrtarëve për inspektim dhe kushtet minimale për funksionim.

Aktualisht, njësi e inspektimit përbehet nga tre zyrtarë,²⁹ të cilët janë përgjegjës për inspektimin e 40 QPS-ve në 38 komuna, Institutin Special në Shtime, Shtëpinë me Bazë në Komunitet për Fëmijë në Shtime, Shtëpinë e Personave të Moshuar në Prishtinë, Strehimoren për Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit në Lipjan, Shtëpitë me Bazë në Komunitet për Personat me Aftësi të Kufizuar në 12 komuna, Shtëpitë me Bazë në Komunitet për Personat e Moshuar në 4 komuna dhe 35 OJQ të licensuara që ofrojnë shërbime sociale.³⁰

Po ashtu, ky raport nxjerr në pah mungesën e një sistemi të mirëfilltë monitorimi nga ana e komunave. Të gjitha DSHMS-të kanë deklaruar që monitorimi nga niveli komunal bëhet vetëm përmes raporteve që ofruesit e shërbimeve i dërgojnë në këto drejtori. Ndërkaq monitorimi në terren nuk mund të bëhet për shkak të mungesës së mjeteve të monitorimit dhe mungesës së kapaciteteve brenda DSHMS-ve. Ka edhe raste kur monitorimi bëhet përmes takimeve të organizuara në mes të DSHMS-së dhe QPS-së ose ofruesve të tjerë dhe këta të fundit raportojnë gojariht për punën.³¹ Gjithashtu, ky lloj raportimi bëhet vetëm për QPS-të por jo edhe për OJQ-të ofruese të shërbimeve sociale që nuk financohen nga komunat.³²

Nga ana tjetër, ofruesit e shërbimeve sociale pohojnë se po ballafaqohen me paqartësi lidhur me monitorimin dhe inspektimin. Ndërkaq, përfaqësuesit e OJQ-ve që ofrojnë shërbime sociale kanë deklaruar se nëse nuk financohen nga institucionet publike (Komuna dhe Ministria), nuk monitorohen dhe nuk inspektohen nga këto institucione. Sipas tyre, ka mungesë të një vije të rregullt komunikimi me institucionet publike. Rekomandohet që monitorimi dhe inspektimi nga komunat dhe niveli qendror të bëhet për të gjithë ofruesit e shërbimeve sociale pa marrë parasysh burimin e financimit.

Fuqishëm rekomandohet të ndahet funksioni i inspektimit dhe monitorimit, përcaktimi i roleve, kompetencave dhe përgjegjësi në mes të nivelit qendror dhe komunal lidhur me inspektimin dhe monitorimin. Inspektimi duhet të bëhet nga niveli qendror, përkatësisht nga MPMS, përderisa monitorimi të bëhet nga niveli komunal. Poashtu rekomandohet të bëhen investime në fuqizimin e Njesisë së Inspektimit përmes dhënies së kompetencave ekzekutive dhe ofrimit të kapaciteteve të nevojshme për kryerjen e funksioneve të kërkuara. Rekomandim afatmesëm është shndërrimi i Njesisë së brendshme të Inspektimit në një njësi apo agjensi jashtë ministrisë, që do ndikonte në inspektim të pavarur për të vlerësuar cilësinë e ofrimit të shërbimeve dhe administrimin e licencimit. Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare në fuqi nuk parashikon licencimin e shërbimeve publike të ofruara nga QPS apo institucionet e tjera publike, prandaj rekomandohet që ky ligj të parashikojë licencimin edhe të shërbimeve të ofruara nga sektori publik, pasi që kjo do të ndikonte në rritjen e cilësisë së shërbimeve sociale. Inspektimi duhet të vlerësojë shërbimet e sektorit publik (QPS) dhe jo-qeveritar.

28 Intervistë me Fitore Rexhaj, Zyrtare e Lartë për Monitorim dhe Inspektim në MPMS, Prishtinë, 31.07.2019

29 Të dhëna nga Adile Shaqiri, Zyrtare e Lartë për Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit, Krimit Seksual dhe Dhunës në Familje në MPMS, 2020

30 Intervistë me Adile Shaqiri, Zyrtare e Lartë për Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit, Krimit Seksual dhe Dhunës në Familje në MPMS, Prishtinë 04.07.2019

31 Intervistë me Fejzë Kabashi, Drejtor në DSHMS në Prizren, 11.06.2019

32 Intervistë me Dren Kukaj, Drejtor në DMS në Prishtinë, 01.08.2019

Aktualisht në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare nuk ka monitorim të jashtëm i cili realizohet nga shoqëria civile dhe kjo konsiderohet të jetë një mangësi. Krahas monitorimit dhe inspektimit të bërë nga institucionet publike, rekomandohet që ligji të parashikojë mundësinë e monitorimit dhe vlerësimit nga sektori joqeveritar/privat. Kjo do të ndikonte në rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe rritjen e llogaridhënies.

Mungesa e kapaciteteve për menaxhimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale në komuna

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, komunat kanë kompetencë menaxhimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale. Ky raport tregon që komunat kanë mungesë të kapaciteteve për menaxhimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale.

Drejtoritë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, vazhdojnë të çalojnë në krijimin e një stafi profesional dhe efektiv brenda këtyre drejtorive. Gjatë monitorimit është gjetur se të gjitha drejtoritë po përballen me mungesën e stafit profesional brenda tyre. Shumica e stafit janë pjesë e administratës, duke qenë të angazhuar vetëm për punë administrative.

Në Drejtorinë e Mirëqenies Sociale në Komunën e Prishtinës, nga shtatë zyrtarë që janë në total, nuk ka asnjë zyrtar të profilizuar dhe me përvojë për shërbime sociale.³³ Ngjashëm qëndron situata edhe në komunat e tjera ku është zhvilluar procesi i monitorimit, ku të gjithë përfaqësuesit e DSHMS-ve kanë pohuar se kanë nevojë për shtim të stafit profesional dhe me përvojë në shërbime sociale në këto drejtori. Për më tepër, shërbimet sociale nuk konsiderohen asnjëherë si prioritet për drejtoritë, pasi përqendrohen kryesisht në fushën e shëndetësisë dhe në prioritetet politike të komunave. Përveç kësaj, stafi në DSHMS nuk përfiton nga trajnimet për shërbime sociale dhe nuk ka njohuri për planifikim, menaxhim dhe monitorim të tyre.

Një e gjetur tjetër e monitorimit është mungesa e fushatave ndërgjegjëse për qytetarët. Në asnjërën nga shtatë komunat e monitoruara nuk ka pasur fushata vetëdijëse për decentralizimin e shërbimeve sociale, rëndësinë e shërbimeve dhe të drejtën e qytetarëve për qasje në këto shërbime. Sipas DSHMS-ve, komunat nuk kanë buxhet as për financimin e shërbimeve sociale, prandaj fushatat vetëdijëse konsiderohen luks.

Ndërkaq, Qendrat për Punë Sociale janë të mandatuar të ofrojnë shërbime sociale për të siguruar mirëqenien e individëve dhe familjeve. Megjithatë, gjatë procesit të monitorimit është vërejtur që QPS-të kanë vështirësi të shumta në përmbushjen e mandatit të tyre.

³³ Intervistë me Dren Kukaj, Drejtor në DMS në Prishtinë, 01.08.2019

Për shkak të kufizimeve në burime njerëzore dhe financiare, aktualisht shërbimet sociale janë të fokusuara në ofrimin e shërbimeve emergjente të mbrojtjes, dhe ka mungesë të ofrimit të shërbimeve të parandalimit dhe re-integrimit, të cilat janë të domosdoshme për mirëqenien e fëmijëve dhe personave në nevojë për shërbime sociale.³⁴ Legjislacioni në fuqi, por edhe kapacitetet e kufizuara financiare dhe njerëzore kanë krijuar sistemin e shërbimeve sociale në Kosovë, i cili trajton dhe menaxhon rastet e rënda emergjente të cilëve ju rrezikohet jeta, siguria apo mirëqenia apo “rastet pasi kanë rënë viktimë e ndonjë forme të abuzimit”. Si pasojë, vetëm një pjesë e vogël e qytetarëve në nevojë kanë mundësinë të përfitojnë nga shërbimet dhe programet sociale. Për më tepër për disa prej fëmijëve apo personave në nevojë për shërbime sociale, sistemi nuk ofron asnjë shërbim, si fjala bie për fëmijët apo personat viktimë të abuzimit me substanca narkotike, fëmijët e përfshirë në punë të rënda etj.

Për shkak të kapaciteteve të kufizuara, të gjithë përfaqësuesit e QPS-ve kanë pohuar që nuk mund të mbulojnë të gjitha kategoritë e shërbimeve dhe nuk kanë mundësi të dalin në terren për të identifikuar familjet në nevojë.

Bazuar në këtë monitorim, QPS-të vazhdojnë të kenë qasje reaktive sa i përket matjes së cënueshmërisë në komunat ku veprojnë. Stafi i pamjaftueshëm në QPS u pamundëson atyre që të kenë qasje pro-aktive drejt identifikimit të klientëve në komunitet, kështu duke mos njohur problemet sociale brenda komunës. QPS-të nuk e perceptojnë këtë matje si proces i cili mund të zhvillohet gradualisht në një periudhë afatmesme apo afatgjatë. Në komunat e mëdha siç është Komuna e Prishtinës, ka disproporcion të madh në mes të numrit të banorëve dhe numrit të zyrtarëve të shërbimeve sociale.³⁵ Përveç kësaj, nga 14 zyrtarë të shërbimeve sociale sa janë në këtë komunë, disa prej tyre nuk janë aktiv për shkak të moshës së shtyrë, djegies / shterimit profesional apo problemeve shëndetësore. Sipas Drejtoreshës së Qendrës për Punë Sociale në Pejë, personat në nevojë paraqiten në QPS, ndërkah stafi i Qendrës nuk ka mundësi të dalë në terren për të identifikuar raste dhe për të matur cënueshmërinë e komunës.³⁶ Numri total i të punësuarve në të gjitha QPS-të është rreth 400 zyrtarë në të dy sektorët që janë shërbimi social dhe skema e asistencës sociale.³⁷ Ndërkah, mesatarja e numrit të rasteve të trajtuara nga një zyrtar i shërbimeve sociale është 150 deri në 170 raste në vit.³⁸ Sipas Drejtorit të DPSF, në kalkulimin e përcaktimit të numrit të zyrtarëve të shërbimeve sociale do të merren për bazë disa indikatorë. Një prej tyre është numri i banorëve në një komunë në relacion me numrin e rasteve që trajtohen dhe sipas këtij kalkulimi planifikohet që përafërsisht në të gjitha QPS-të të jenë 500 punëtorë social në gjithë Kosovën, që i bie numri i zyrtarëve të shërbimeve sociale të rritet për 100 zyrtarë.³⁹

Te gjitha këto kalkulime do të duhet të dalin nga dokumenti i formulës së financimit të shërbimeve sociale i cili do t'i propozohet Ministrisë Financave, Komunave dhe akterëve të tjerë për të i cili koston e nevojave të financimit për shërbime sociale sipas Grantit Specifik për Shërbime Sociale. Aprovimi i këtij Granti do të varet nga politikat dhe programi qeveritar i Qeverisë së re.

Një shqetësim tjetër i deklaruar nga QPS-të është ndërhyrja politike e komunave në punësimin e stafit brenda QPS-ve, gjë që po dëmton rëndë funksionimin dhe ofrimin e shërbimeve brenda QPS-ve. Shpesh

34 Indeksi i Mbrojtjes së Fëmijës 2.0, KOMF 2018, <http://www.komfkosova.org/lep-content/uploads/2018/01/Child-Protection-Index-2.0.pdf>

35 Intervistë me Naime Azemi, Zyrtare e Shërbimeve Sociale, QPS në Prishtinë, 27.05.2019

36 Intervistë me Drita Kukaj, Drejtoreshë në QPS në Pejë, 22.07.2019

37 Të dhëna nga Mentor Morina, Drejtor në DPSF, MPMS, 2020

38 Të dhëna nga Abaz Xhigoli, Drejtor në QPS në Fushë Kosovë, 2020

39 Të dhëna nga Mentor Morina, Drejtor në DPSF, MPMS, 2020

herë ndodh që për shkak të ndërhyrjes politike të komunave, në QPS punësohen persona të cilët nuk plotësojnë kriteret bazuar në ligjet në fuqi. Kjo duke filluar nga kriteri bazë për profesionin i kërkuar në Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare, e që për pasojë personat në fjalë nuk mund të pajisen asnjëherë me licencë nga MPMS. Situata rëndohet edhe më shumë për faktin që Njësia për Monitorim dhe Inspektim në MPMS nuk ka kompetenca ekzekutive, pra nuk mund të shqiptojë masa ose sanksione për këto raste. Po ashtu, komunat nuk respektojnë parimin e punës multidisiplinare në QPS. Komunat nuk e marrin për bazë faktin që QPS-të duhet të ketë në përbërje profesionistë nga lëmi të ndryshme të kërkuara me ligj sikurse punëtor social, psikolog, pedagog, sociolog dhe jurist. Në disa prej QPS-ve ndodh që stafi të ketë në përbërje 6 juristë dhe asnjë profil tjetër. Kjo bie ndesh me parimin e punës multidisiplinare, e që për QPS kjo përbën një ndër parimet themelore.

Zyrtarët për shërbime sociale nuk janë të profilizuar dhe si pasojë punojnë me të gjitha lëndët dhe kategoritë në nevojë. Ligji i ri për Shërbime Sociale dhe Familjare duhet të parashikojë një reformë sa i përket ofrimit të shërbimeve sociale, duke përcaktuar shërbimet e parandalimit, mbrojtjes, rehabilitimit dhe re integrimit, si dhe duke i klasifikuar shërbimet në tri kategori/nivele në ato primare, sekondare dhe terciare. Në mungesë të një skeme për kontraktimin e shërbimeve sociale nga sektori jo-qeveritar ose privat, zyrtarët e shërbimeve sociale detyrohen të punojnë me të gjitha kategoritë. Kontraktimi i shërbimeve sociale nga sektori jo-qeveritar ose privat, do të mundësonte organizim më të mirë të shërbimeve duke zhvendosur disa nga shërbimet sociale nga QPS në sektorin jo qeveritar ose atë privat. KOMF propozon përcaktimin e qartë të shërbimeve sociale të cilat mund të kontraktohen, shërbimet që mund të ofrohen në bashkëpunim me ofrues të tjerë dhe shërbimet që nuk mund të kontraktohen por ofrohen ekskluzivisht nga sektori publik.

Për të rritur cilësinë e shërbimeve si dhe performancën e ofruesve të shërbimeve, rekomandohet që Ligji i ri për Shërbime Sociale dhe Familjare të parashikojë profilizimin e punëtorëve social/zyrtarëve të shërbimeve sociale sipas përfituesve. Duke pas parasysh burimet njerëzore të kufizuara, rekomandohet që ky proces të zhvillohet gradualisht në mënyrë progresive. Si fazë e parë, rekomandohet profilizimi i punëtorëve social/zyrtarëve të shërbimeve sociale për punën me fëmijë dhe me të rritur. Përderisa, më tutje të bëhen planifikimet për profilizim edhe sa i përket ndarjes në kategori. Po ashtu rekomandohet që Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare të harmonizohet me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve sa i përket organizimit të zyrtarëve të shërbimeve sociale, duke qenë se ky ligj parasheh zyrtarët për mbrojtjen e fëmijëve në kuadër të QPS.

Përveç nevojave për kapacitete financiare dhe njerëzore, stafi i QPS-ve dhe ofruesve tjerë të shërbimeve sociale, ka nevojë për zhvillim profesional. Aktualisht nuk ka një plan vjetor të trajnimeve të dizajnuar nga MPMS, përkundër faktit që kërkesë e standardeve minimale është mbajtja e trajnimeve të rregullta për secilën kategori. Përveç kësaj, nuk ka programe të akredituara të trajnimeve për shërbime sociale. Ligji në fuqi për Shërbime Sociale dhe Familjare nuk parashikon mënyrën e akreditimit të programeve për shërbime sociale. Trajnimet kryesisht ofrohen të paplanifikuara, në baza ad hoc dhe varen nga mbështetja e donatorëve apo organizatave jo-qeveritare.

Për të funksionalizuar ofrimin e shërbimeve sociale në nivel komunal, rekomandohet që të zhvillohen kapacitetet e DSHMS-ve dhe QPS-ve për ofrim të shërbimeve sociale. Rekomandohet që Drejtoritë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, të profilizojnë stafin profesional për fushën e shërbimeve sociale, sidomos në planifikim, menaxhim dhe monitorim të shërbimeve sociale. Rritja e numrit dhe profilizimi i zyrtarëve duhet të ndodhë edhe në QPS, duke u siguruar që kanë në përbërje profesionistë nga lëmitë e kërkuara me ligj. Zhvillimi profesional dhe profilizimi i stafit në nivel komunal do të mundësonte menaxhim të duhur të punës brenda dy institucioneve dhe do të mundësonte ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët.



PËRFUNDIMI

Përfundim

Ky raport monitorimi vërteton që procesi i decentralizimit të shërbimeve sociale i filluar tashmë prej 10 vitesh, nuk është përmbyllur. Arsyeja kryesore e mos-zbatimit të këtij procesi është mungesa e vullnetit politik si nga ana e nivelit qendror, ashtu edhe nga ana e nivelit komunal. Nga gjithsej shtatë komuna në të cilat është bërë monitorimi i decentralizimit të shërbimeve sociale, rezulton se në asnjë prej tyre nuk është zbatuar procesi i decentralizimit të shërbimeve sociale.

Qeveria nuk e ka pasur asnjëherë prioritet deri më tani ndryshimin e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal dhe zgjidhjen e problemit të financimit për shërbime sociale. Ndërkaq, komunat vazhdojnë të neglizhojnë marrjen e përgjegjësisë për menaxhimin e shërbimeve sociale.

Bazuar në të gjeturat e monitorimit, shërbimet sociale janë në gjendje shumë të rëndë dhe po përballen me sfida të shumta, përfshirë: mungesën e financimit të qëndrueshëm të shërbimeve sociale, cilësinë e dobët të shërbimeve, kapacitetet e kufizuara, mungesën e infrastrukturës, llogaridhënien e ulët, paqartësitë në ndarjen e përgjegjësisë në mes të nivelit qendror dhe komunal, paqartësitë në ndarjen e funksioneve të monitorimit dhe inspekimit, mungesën e të dhënave, si dhe mungesën e bashkëpunimit dhe komunikimit në mes të nivelit qendror dhe komunal.



REKOMANDIME

Rekomandime

Duke pasur parasysh gjendjen e rëndë lidhur me financimin e shërbimeve sociale si dhe faktin që Granti Specifik për Shërbime Sociale për shkak të procedurave ligjore nuk pritet të aplikohet gjatë vitit 2021 dhe 2022, rekomandohet që gjatë kësaj periudhe MPMS dhe Komunat të ndërmarrin disa veprime urgjente:

- MPMS të rrisë prapën e minimumit të financimit për shërbimet sociale të ofruara nga sektori jo-qeveritar, në mënyrë që të mundësohet vazhdimi i ofrimit të shërbimeve për qytetarët në nevojë. MPMS të eliminojë zbrazëtitë kohore të krijuara mes thirrjeve për financim të shërbimeve nga MPMS, në mënyrë që të mos ketë mbyllje të shërbimeve.
- Komunat të ndërmarrin të gjitha masat për të siguruar financimin e shërbimeve sociale direkte brenda komunës së tyre përmes mbështetjes financiare të QPS-ve dhe blerjes së shërbimeve nga sektori jo-qeveritar.

Bazuar në të gjeturat e këtij monitorimi, janë hartuar rekomandimet kryesore që duhet merren parasysh nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e procesit të decentralizimit.

- Prioritizimi i zbatimit të procesit të decentralizimit të shërbimeve sociale në nivelin qendror dhe komunal. Qeveria e Kosovës dhe komunat duhet të investojnë në rregullimin ligjor të financimit të shërbimeve sociale, ndarjen e qartë të përgjegjësisë në mes të nivelit qendror dhe komunal, rritjen e llogaridhënies në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, ngritjen e infrastrukturës dhe kapaciteteve si dhe investimin në zhvillimin profesional të komunave dhe ofruesve të shërbimeve. MPMS të marrë përsipër rolin udhëheqës dhe fasilitues në përmbylljen e këtij procesi.
- Krijimi i Grantit Specifik për Shërbime Sociale në kuadër të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, për të siguruar financim të qëndrueshëm dhe të drejtë për shërbimet sociale dhe familjare. Granti Specifik për Shërbime Sociale duhet të jetë i bazuar në standardet minimale të MPMS, formulën e financimit të shërbimeve sociale si dhe kriteret dhe indikatorët social në komuna. Shuma totale e shpenzimeve aktuale për të gjitha kategoritë e shpenzimeve për QPS-të dhe financimin e institucioneve rezidenciale, është rreth 10 milionë Euro. Rekomandohet që në vitin e parë të zbatimit të Ligjit të ri për Financat e Pushtetit Lokal shuma totale e ndarë përmes Grantit Specifik të jetë 15 milionë Euro, që i bie që buxheti për shërbime sociale të rritet për 5 milionë Euro.
- Hartimi i formulës së financimit për shërbimet sociale nga MPMS. Formula e financimit duhet të nxjerrë koston për njësi për secilin klient për shërbime sociale si dhe duhet të marrë parasysh kriteret në territorin e një komune: numri i QPS-ve, numri i qendrave rezidenciale, numri i qendrave ditore, numri i zyrtarëve të shërbimeve sociale në përpjesëtim me numrin e banorëve dhe numrin e rasteve, numri i fëmijëve në bazë të grup-moshave dhe të rriturve të cënuar apo rrezikuar, numri i viktimave të dhunës në familje, trafikimit dhe abuzimit, numri i personave me nevoja të veçanta, numri i personave të moshuar mbi moshën 65 vjeç, dhe numri i familjeve në asistencë sociale në relacion me sipërfaqen e territorit komunal.

- Përcaktimi i rolit dhe ndarja e përgjegjësi të institucioneve të nivelit qendror dhe komunal në kuadër të Ligjit të ri për Shërbime Sociale dhe Familjare, për të shmangur paqartësitë rreth shërbimeve sociale. Rekomandohet rregullimi i raportimit në nivel horizontal dhe vertikal, standardizimi i formave të raportimit dhe ndarjes së të dhënave duke pasur parasysh ruajtjen e konfidencialitetit.
- Ndarja e funksionit të inspektimit dhe monitorimit në kuadër të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare. Fuqishëm rekomandohet përcaktimi i roleve, kompetencave dhe përgjegjësi në mes të nivelit qendror dhe komunal lidhur me inspektimin dhe monitorimin. Inspektimi duhet të bëhet nga niveli qendror, përkatësisht nga MPMS, përderisa monitorimi të bëhet nga niveli komunal DSHMS. Poashtu rekomandohet të bëhen investime në fuqizimin e njësisë së inspektimit përmes dhënies së kompetencave ekzekutive dhe ofrimit të kapaciteteve të nevojshme për kryerjen e funksioneve të kërkuara. Rekomandim afatmesëm është shndërrimi i njësisë së brendshme të inspektimit në një njësi apo agjension jashtë ministrisë, që do ndikonte në inspektim të pavarur për të vlerësuar cilësinë e ofrimit të shërbimeve dhe administrimin e licencimit.
- Monitorimi dhe vlerësimi nga sektori joqeveritar/privat. Krahas monitorimit dhe inspektimit të bërë nga institucionet publike, rekomandohet që Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare të parashikojë mundësinë e monitorimit dhe vlerësimit nga sektori joqeveritar/privat. Kjo do të ndikonte në rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe rritjen e llogaridhënies.
- Licencimi i shërbimeve sociale të ofruara nga sektori publik. Rekomandohet që kjo të parashikohet në Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare. Licencimi i shërbimeve të ofruara nga institucionet publike do të siguronte llogaridhënie dhe monitorim të mëtijshëm të të gjithë ofruesve të shërbimeve publike, duke ndikuar kështu në rritjen e cilësisë së shërbimeve sociale.
- Krijimi i një skeme të qëndrueshme nga komunat për kontraktimin e shërbimeve sociale dhe familjare nga sektori jo-qeveritar. Kontraktimi duhet të bëhet në emër të blerjes së shërbimeve për ofrimin e shërbimeve sociale, në mënyrë që të sigurojë financim të qëndrueshëm dhe afatgjatë. Ofrimi i mbështetjes përmes subvencioneve nuk është i qëndrueshëm dhe nuk konsiderohet si forma më e përshtatshme e financimit të shërbimeve të sektorit jo-qeveritar. Komunat duhet tu përmbahen standardeve minimale të MPMS gjatë kontraktimit të shërbimeve. Komunat duhet të lidhin kontrata me organizatat jo-qeveritare të licencuara dhe të dëshmuara me përvojën dhe profesionalizimin e tyre në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, në emër të komunës.
- Fuqizimi i komunave dhe QPS-ve për planifikim dhe menaxhim të buxhetit. Rekomandohet që Drejtoritë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, të zhvillojnë dhe profilizojnë stafin profesional për fushën e shërbimeve sociale. Posaçërisht, rekomandohet ngritja e kapaciteteve për planifikim, menaxhim dhe monitorim të shërbimeve sociale. Duke qenë se pas aplikimit të Grantit Specifik për Shërbime Sociale, buxheti pritët të bartet QPS-ve, ato duhet të jenë të përgatitura për pranim të kompetencave për planifikim dhe menaxhim të buxhetit për ofrimin e shërbimeve sociale. Planifikimi buxhetor duhet të ketë për bazë nevojat e qytetarëve brenda komunës, nevojën për shërbime sociale cilësore, si dhe zhvillimin profesional të ofruesve të shërbimeve.
- Ligji i ri për Shërbime Sociale dhe Familjare të parashikojë një reformë sa i përket shërbimeve sociale, duke përcaktuar shërbimet e parandalimit, mbrojtjes, rehabilitimit dhe re integritetit, si dhe duke i klasifikuar shërbimet në tri kategori/nivele, duke garantuar kështu të drejtën në shërbime sociale për të

gjithë fëmijët dhe personat në nevojë për shërbime sociale. Për më tepër, rekomandohet që ky ligj të parashohë organizim të ri të shërbimeve duke zhvendosur disa nga shërbimet sociale nga QPS në sektorin jo qeveritar apo privat.

- Rritja e numrit dhe profilizimi i zyrtarëve të shërbimeve sociale në QPS për të respektuar standardet minimale të MPMS për numrin e zyrtarëve në raport me numrin e përfituesve. QPS duhet të sigurojë se ka në përbërje profesionistë nga lëmitë e kërkuara me ligj sikurse punëtor social, psikolog, pedagog, sociolog dhe jurist. Poashtu rekomandohet profilizimi i zyrtarëve të shërbimeve sociale sipas kategorive të përfituesve të shërbimeve, në sektorin publik. Duke pasur parasysh burimet njerëzore të kufizuara, rekomandohet që ky proces të zhvillohet gradualisht në mënyrë progresive. Si fazë e parë, rekomandohet profilizimi i zyrtarëve të shërbimeve sociale për punën me fëmijë dhe me të rritur. Përderisa, më tutje të bëhen planifikimet për profilizim edhe sa i përket ndarjes në kategori.
- Krijimi i një njësie trajnimit në kuadër të MPMS-së, e cila do të merret me trajnime dhe aftësim të vazhdueshëm të zyrtarëve të shërbimeve sociale. Rekomandohet që programet e zhvilluara nga njësia e trajnimeve për shërbime sociale të akreditohen dhe të jenë konform standardeve minimale dhe kërkesave të licencimit. Poashtu, është më se i domosdoshëm krijimi i një plani vjetor të trajnimeve i dizajnuar nga MPMS dhe i bazuar në programet e akredituara dhe kërkesat e standardeve të miratuara po nga MPMS. Në kuadër të këtij plani vjetor, është e rëndësishme të përfshihet edhe planifikimi buxhetor i trajnimeve në baza vjetore.
- Zhvillimi i fushatave vetëdijesuese nga komunat dhe MPMS për decentralizimin e shërbimeve sociale, rëndësinë e shërbimeve dhe të drejtën e qytetarëve për qasje në këto shërbime.



SHTOJCA

Shtojca 1

Lista e të intervistuarve:

1	Mentor Morina Departamenti për Politika Sociale, MPMS Drejtor i Departamentit të Politikave Sociale	6	Petrit Loci DSHMS, Komuna e Pejës Drejtor	12	Ahmet Fejzullahu QPS, Komuna e Prishtinës U.D. Drejtor
2	Fitore Rexhaj Departamenti për Politika Sociale, MPMS Zyrtare e lartë për Monitorim he Inspektim të Shërbimeve Sociale dhe Familjare	7	Fejzë Kabashi DSHMS, Komuna e Prizrenit Drejtor	13	Naime Azemi QPS, Komuna e Prishtinës Zyrtare e Shërbimeve Sociale
3	Adile Shaqiri Departamenti për Politika Sociale, MPMS Zyrtare e lartë për Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit, Krimin Seksual dhe Dhunës në Familje	8	Bekim Ademi DSHMS, Komuna e Ferizajit Drejtor	14	Makfirete Shamolli QPS, Komuna e Lipjanit Drejtor
4	Dren Kukaj DSHMS, Komuna e Prishtinës Drejtor	9	Kimete Kryeziu DSHMS Komuna e Kamenicës U.D. Drejtor	15	Drita Kukaj QPS, Komuna e Pejës Drejtor
5	Vlora Limani Hajnuni DSHMS, Komuna e Lipjanit Drejtor	10	Jakup Dumani DSHMS, Komuna e Fushë Kosovës Drejtor	16	Kumrije Bytyqi QPS, Komuna e Prizrenit U.D. Drejtor
		11	Hysen Sllamniku DSHMS, Komuna e Fushë Kosovës Zyrtar për Mirëqenie Sociale	17	Ruzhdi Latifi QPS, Komuna e Ferizajit Drejtor
				18	Adelina Rexhepi QPS, Komuna e Ferizajit Udhëheqëse e Shërbimeve Sociale

19

Hamdie Selmani

QPS, Komuna e Ferizajit
Zyrtare e Shërbimeve Sociale

20

Musa Baftiu

QPS, Komuna e Ferizajit
Zyrtare e Shërbimeve Sociale

21

Rifat Hajdari

QPS, Komuna e Kamenicës
Drejtor

22

Abaz Xhigoli

QPS, Komuna
e Fushë Kosovës
Drejtor

23

Zana Shabani

Terredeshommes (OJQ),
Komuna e Prishtinës
Koordinatore e projekteve

24

Safet Blakaj

Labyrinth (OJQ),
Komuna e Prishtinës
Koordinatore e projekteve

25

Gani Lluga

ASTRA (OJQ),
Komuna e Prishtinës
Drejtor

26

Fitim Sadiku

POLIS (OJQ),
Komuna e Lipjanit
Drejtor

27

Naser Lajqi

Syri i Vizioinit (OJQ),
Komuna e Pejës
Menaxher i Programeve në
fushën e Mbrojtjes së
Fëmijëve

28

Flori Jupa

Autizmi (OJQ),
Komuna e Prizrenit
Punëtor Social

29

Yllka Bega

Handikos (OJQ),
Komuna e Ferizajit
Zyrtare për Mbrojtjen dhe
Qeverisjen e të Drejtave
të Fëmijëve

30

Besime Tusha

NOPM (OJQ),
Komuna e Kamenicës
Drejtor

31

Rexhep Gojnovci

Akti (OJQ),
Komuna e Fushë Kosovës
Drejtor

Shtojca 2

Pyetësorët për monitorimin e procesit të decentralizimit:

a) Pyetësori për nivelin qendror (MPMS):

1. A janë kompetencat e përcaktuara në mënyrë të qartë në mes të nivelit qendror dhe nivelit lokal, sa i përket procesit të decentralizimit? (sqaro)
2. A ka pasur vullnet politik nga ana e Ministrisë për të implementuar procesin e decentralizimit? (sqaro)
3. A është bërë decentralizimi i buxhetit për shërbime sociale?
 - 3.1. Cila është zgjidhja e duhur për decentralizimin e buxhetit të shërbimeve sociale?
 - 3.2. A mendoni se përmes grantit të veçantë do të zgjidhet ky proces?
 - 3.3. A është hartuar formula e financimit, apo nxjerrja e kostos së shërbimeve për njësi?
4. Si ndahet buxheti për QPS-të dhe OJQ-të të cilat ofrojnë shërbime sociale?
 - 4.1. A ekzistojnë kriteret të qarta dhe nëse po, cilat janë ato?
5. A ka Ministria rol monitorues në relacion me shërbimet sociale?
 - 5.1. Nëse po, si bëhet monitorimi?
6. Në çfarë forme bëhet inspektimi i QPS-ve dhe OJQ-ve ofruese të shërbimeve sociale?
 - 6.1. Cilat janë sfidat dhe nevojat?
7. A ka themeluar Ministria ndonjë program për zhvillimin profesional të nëpunësve social?
 - 7.1. Nëse po cilat janë ato programe dhe sa herë brenda vitit janë zhvilluar?
 - 7.2. Cilat kanë qenë temat e trajtuara në këto programe (trajnime)?
 - 7.3. Kush dhe sa persona kanë përfituar nga mbajtja e këtyre trajnimeve?
8. A është bërë decentralizimi i strehimit familjar?
 - 8.1. Nëse jo, pse?
 - 8.2. Nëse po, sqaro si?
9. A ka Ministria të dhëna të nevojshme për të vlerësuar faktorët e rrezikut përmes Anketës së Buxhetit Familjar?
 - 9.1. A janë përcaktuar indikatorët social?

10. Cila është mënyra e komunikimit të brendshëm në mes të Ministrisë, DSHMS, QPS-ve dhe OJQ-ve tjera që ofrojnë shërbime sociale?
 - 10.1. A ka forma (protokole) të raportimit?
 - 10.2. Në çfarë periudhash kohore bëhet raportimi?
 - 10.3. Nëse ka protokole, a respektohen ato?
11. Si është bashkëpunimi në mes të nivelit qendror, lokal dhe OJQ-ve?

b) Pyetësi për nivelin lokal (komunat/DSHMS): _____

1. A janë kompetencat të përcaktuara në mënyrë të qartë në mes të nivelit qendror dhe nivelit lokal, sa i përket procesit të decentralizimit? (sqaro)
2. A ka pasur vullnet politik nga ana e Komunës për të implementuar procesin e decentralizimit? (sqaro)
3. A është bërë decentralizimi i buxhetit për shërbime sociale?
 - 3.1. Cila është zgjidhja e duhur për decentralizimin e buxhetit të shërbimeve sociale?
 - 3.2. A mendoni se përmes grantit të veçantë do të zgjidhet ky proces?
4. Si ndahet buxheti për OJQ-të të cilat ofrojnë shërbime sociale?
 - 4.1. Si bëhet kontraktimi i shërbimeve sociale nga komunat?
 - 4.2. A ekzistojnë kritere të qarta dhe nëse po, cilat janë ato?
 - 4.3. A shpall komuna thirrje në mënyrë të rregullt për kontraktimin e shërbimeve sociale nga OJQ-të?
 - 4.4. Sa ka qenë shuma që ka ndarë Komuna mjete për shërbime sociale gjatë 2018? Për QPS dhe kontraktimin e OJQ-ve?
5. A keni ju si komunë informacione të sakta lidhur me numrin e personave që janë në nevojë?
 - 5.1. Si merren këto informacione?
6. A ka DSHMS kapacitete njerëzore, burime njerëzore të kualifikuar dhe me eksperiencë për shërbimet sociale?
 - 6.1. Sa është numri i stafit brenda DSHMS?
 - 6.2. Cilat janë profilet (profesionet) e tyre?

7. A i monitoron DSHMS institucionet që ofrojnë shërbimet sociale (përfshirë këtu QPS-të dhe OJQ-të)?
 - 7.1. Nëse po, si bëhet monitorimi?
8. A ka zhvilluar Komuna ndonjë fushatë vetëdijësuese lidhur me ngritjen e vetëdijes së publikut për të drejtën e tyre për të përfituar nga shërbimet sociale?
9. A ka DSHMS dhe QPS kapacitete të hartojë planifikimin buxhetor (kërkesën) për shërbime sociale?
 - 9.1. Nga kush bëhet kërkesa për buxhet drejtuar Komunës?
 - 9.2. A ka kapacitete Drejtoriadhe QPS rreth procedurave të prokurorimit për kontraktimin e shërbimeve sociale?
 - 9.3. A ka kapacitete QPS që të bëjë menaxhimin e buxhetit?
10. A është bërë decentralizimi i strehimit familjar?
 - 10.1. Nëse jo, pse?
 - 10.2. Nëse po, sqaro si.
11. Cila është mënyra e komunikimit të brendshëm në mes të Ministrisë, DSHMS, QPS-ve dhe OJQ-ve tjera që ofrojnë shërbime sociale?
 - 11.1. A ka forma (protokole) të raportimit?
 - 11.2. Në çfarë periudha kohore bëhet raportimi?
 - 11.3. Nëse ka protokole, a respektohen ato?
12. A ekziston një manual për operimin e shërbimeve sociale në komunë duke u bazuar në Ligjin për Vetë-Qeverisje Komunale dhe Kartën Evropiane mbi Qeverinë Lokale, duke u fokusuar në shërbime sociale?
13. Si i organizon Komuna shërbimet sociale?
 - 13.1. Si kontraktohen OJQ-të?
 - 13.2. Si përcaktohen prioritetet dhe kriteret për kontraktimin e tyre?
14. Si është bashkëpunimi në mes të nivelit qendror, lokal dhe OJQ-ve?

c) Pyetësi për QPS-të:

1. A janë kompetencat të përcaktuara në mënyrë të qartë në mes të nivelit qendror dhe nivelit lokal, sa i përket procesit të decentralizimit? (sqaro)
2. A ka pasur vullnet politik nga ana e Ministrisë dhe Komunës për të implementuar procesin e decentralizimit? (sqaro)
3. A është bërë decentralizimi i buxhetit për shërbime sociale?
 - 3.1. Cila është zgjidhja e duhur për decentralizimin e buxhetit të shërbimeve sociale?
 - 3.2. A mendoni se përmes grantit të veçantë do të zgjidhet ky proces?
4. A i mbulon buxheti aktual nevojat e shërbimeve sociale?
 - 4.1. Për cilat nga shërbimet ju keni buxhet të mjaftueshëm (listo)?
5. A ka QPS kapacitete të hartojë planifikimin buxhetor për shërbime sociale?
 - 5.1. Nga kush bëhet kërkesa për buxhet drejtuar Komunës?
6. A ka QPS kapacitete për menaxhimin e buxhetit për shërbime sociale?
 - 6.1 A mendoni që QPS duhet të ketë konton e saj bankare dhe të menaxhojë me buxhetin, apo duhet që buxheti të menaxhohet nga komuna (DSHMS)?
 - 6.2 A ka QPS financier?
7. Cila është mënyra e komunikimit të brendshëm në mes të Ministrisë, DSHMS-ve, QPS-ve dhe OJQ-ve tjera që ofrojnë shërbime sociale?
 - 7.1. A ka forma (protokole) të raportimit?
 - 7.2. Në çfarë periudhash kohore bëhet raportimi?
 - 7.3. Nëse ka protokole, a respektohen ato?
 - 7.4. Çfarë raportesh dorëzohen në DSHMS dhe çfarë në MPMS?
8. Cili është organogrami i QPS-së/OJQ-së
9. A ka QPS/OJQ të dhëna statistikore mbi personat në nevojë?
 - 9.1. A e shihni si mundësi që QPS/OJQ të del në teren për të mbledhur të dhëna të sakta mbi numrin dhe gjendjen e personave në nevojë?
10. Si është bashkëpunimi në mes të nivelit qendror, lokal dhe OJQ-ve?

d) Pyetësi për OJQ-të që ofrojnë shërbime sociale: _____

1. Si e shihni procesin e decentralizimit? A janë kompetencat të përcaktuara në mënyrë të qartë në mes të nivelit qendror dhe nivelit lokal, sa i përket procesit të decentralizimit? (sqaro)
2. A ka pasur vullnet politik nga ana e Ministrisë dhe Komunës për të implementuar procesin e decentralizimit? (sqaro)
3. A i mbulon buxheti aktual nevojat e shërbimeve sociale?
- 3.3 Aktualisht, nga cilat burime (donatorë) mbulohen shërbimet sociale të organizatës tuaj?
4. A nxjerr komuna shpallje thirrje për financimin e shërbimeve sociale?
5. Cila është mënyra e komunikimit në mes jush (OJQ), Komunës, DSHMS, QPS dhe MPMS?
6. Cila është mënyra e raportimit nga ju drejt Komunës, DSHMS, QPS dhe MPMS? (nëse bëhet raportimi)
7. A keni pasur monitorim/inspektim nga Komuna, MPMS?
8. Cilat janë sfidat me të cilat përballlet OJQ në ofrim të shërbimeve sociale?
9. Cilat janë nevojat e OJQ-ve që ofrojnë shërbime sociale?
10. Si është bashkëpunimi mes OJQ, komunës dhe MPMS?

Shtojca 3

Dokumentet e shqyrtuara

Korniza ligjore:

Ligji nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal

Ligji nr. 05/L-108 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal

Ligji nr. 06/L-133 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2019 - Tabelat e Buxhetit për Vitin 2019

Ligji nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë

Ligji nr. 04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë

Ligji nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare

Ligji nr. 04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare

Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale

Strategjia sektoriale e MPMS 2014 – 2020

Statutet e Qendrave për Punë Sociale

Koncept Dokumenti për Financat e Pushtetit Lokal, Ministria e Financave

Koncept Dokumenti për Shërbime Sociale, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Raportet:

Financimi i Shërbimeve Sociale, KOMF 2017

Hartëzimi i sistemeve për mbrojtjen e fëmijëve në EU, Agjencia e Bashkimit European për të Drejtat të Njeriut

Konteksti ligjor dhe fiskal si dhe kapacitetet e ofruesve të shërbimeve sociale në Kosovë, Analizë e situatës, Save the Children 2018

Indeksi për Mbrojtjen e Fëmijës, KOMF 2017 dhe 2018

Platforma buxhetore, Instituti GAP

Raporti i Progresit të Kosovës 2018, Zyra e BE-së në Kosovë

Organizatat anëtare të KOMF janë: Asociacioni për Trajnime Sociale, Hulumtime dhe Avokim – ASTRA, Aksioni për Nëna dhe Fëmijë, Balkan Sunflowers Kosova, Childproof/CIPOF, Education Comes First – ECF, Iniciativa 6, Organizata Rinore Akti – Ora, Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror – OFAP, OPFAKKOS, Programi për të Drejtat Civile – CRP/K, PL4Y International, Qendra për Arsim e Kosovës – KEC, Qendra e Kujdesit Ditor PEMA, Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit të qenieve njerëzore – MVPT, Qendra për Studime të Avancuara – FIT, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës – QKRMT, Save the Children, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijët Kosovë – SDSF, Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë – PRAK Kosova, Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës – HANDIKOS, Terre des hommes, The Ideas Partnership, VoRAE, World Vision, Public Organization for Local Initiatives and Supports – POLIS, Network of Peace Movement – NOPM, Qendra Sociale – Edukative SOS Kopshti dhe Nevo Koncepti.

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve
Zenel Salihu, OB.1 HY.1 K.3 No.16,
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 (0) 38 220 287
Info@komfkosova.org
www.komfkosova.org

Financuar nga:



Implementuar nga:

